



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR



Nr 19345 prot.datë 12.12.2023

Nr 132 prot. datë 04.01.2023

KONTRATË QIRAJE

E lidhur sot me dt. _____.____.2023 ndërmjet palëve:

1.Qiradhënësi : Bashkia Shkodër, institucion publik me nr NIPT K36813001H, me vendndodhje në Rr. “13 Dhjetori”, Shkodër, përfaqësuar nga Z/Kryetari z.Onid BEJLERI me vendim delegim kompetence nr. 325 datë 02.10.2023, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, që më poshtë do të quhet “Qiradhënësi”.

Dhe

2.Qiramarrësi : Shoqëria “Banka e Tiranës” Sh.A. – e organizuar dhe që ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NUIS J61924008V, me seli në Krugën “Ibrahim Rugova” Tiranë, përfaqësuar nga përfaqësueset e posaçme:

Drejtoresha e Divizionit të Rekuperimeve Bankare, znj. Elona SEJKO (GJIPALI), e bija e Koços, e datelindjes 31.08.1976, lindur në Tiranë, banuese në adresën Bulevardi “Zogu I”, Pall 9/13/15, Seksioni 2, Ap. 34, Tiranë, identifikuar me leternjoftimin Nr.030614391 (Nr. Personal H65831109E), madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe Drejtoresha e Divizionit Operacional (COO),

znj. Eralda TAFAJ, e bija e Xhevdetit, e datelindjes 01.05.1978, lindur në Tiranë, banuese në adresën Rruga “Isa Boletini”, Tiranë, identifikuar me leternjoftimin Nr.034765635 (Nr. Personal H85501240Q), madhore e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në bazë të Prokures së Posaçme me Nr.236 Rep, e Nr.130/2 Kol, datë 30.01.2017, që më poshtë do quhet “Qiramarrësi”.

Baza ligjore:

- Ligji nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar.
- Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar
- VKM nr. 54, datë 05.02.2014 “ Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qera, enfitotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar.
- VKB nr. 59, datë 30.09.2017 “Për dhënie pëlqimi për dhënie me qira një ambienti me sipërfaqe 7.5 m², pronë e Bashkisë Shkodër”



[Handwritten signature]



Neni 1 Objekti i kontratës

1.1 Objekti i kësaj kontrate, është dhënia me qira e pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 7.5 m² pjesë e pasurisë së paluajtshme me nr. 4/250, në Zonën Kadastrale 8594, volum 17, faqe 166, ndodhur në qytetin Shkodër, rruga “28 Nëntori”, pasuri në pronësi të Bashkisë Shkodër, me qëllim që Banka ta përdorë për vendosjen e një bankomati (me poshte “ATM”) gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate sipas kushteve të mëposhtme dhe planimetrisë bashkëngjitur.

Neni 2 Pagesa

2.1 Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiradhënësit detyrimin mujor në vlerën prej 1305 (një mijë e tre qind e pesë) lekë /muaj/.

2.2 Pagesa e qirasë do të jetë mujore dhe do të bëhet brenda datës 10(dhjetë) të fillimit të muajit për llogari të Institucionit (Bashkia Shkodër), në llogarinë e të ardhurave, Dega e Thesarit Shkodër.

Ose

2.3 Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë qiradhënësit detyrimin vjetor në vlerën 15.660 (pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë/vit.

2.4 Pagesa e qirasë do të jetë mujore/ vjetore dhe do të bëhet në llogarinë e të ardhurave, Dega e Thesarit Shkodër.

Neni 3 Afati i Kontratës - Përfundimi – Zgjidhja

3.1 Kohëzgjatja e kësaj kontrate është 1(një) vit kalendarik.

3.2 Efektet financiare fillojnë nga data 12.12.2023 deri me datë 11.12.2024.

3.3 Kjo kontratë do të përfundojë në datën e mbarimit të afatit të kohëzgjatjes së kontratës, përcaktuar në paragrafin e mësipërm, pa qenë e nevojshme shpallja e mbarimit të saj.

3.4 Secila palë kontraktuese mund ta përfundojë në mënyrë të njëanshme këtë kontratë në rastet kur:

a) palët bien dakort që mund të zgjidhin kontratën nëpërmjet një njoftimi paraprak me shkrim 1 (nje) mujor drejtuar palëve, duke mos shkaktuar dëm kështu asnjërës prej palëve dhe pa u kërkuar kryerja e ndonjë procedure tjetër.

b) Kjo kontratë mund të zgjidhet nga secila prej palëve, me efekt të menjëhershëm, në rast të shkeljes së ndonjë prej kushteve të saj ose për shkak të evidentimit të rasteve të forcës madhore.

3.5 Në rast të zgjidhjes së kontratës para afatit si dhe në rast ku pagesa është bërë paraprakisht për të gjithë kohëzgjatjen e kontratës nga Qiramarrësi sipas pikës 2.3 më sipër, atëherë Qiradhënësi detyrohet të kthejë shumën përkatëse në varësi të momentit të zgjidhjes së kontratës.



2



- 6.7 Qiramarrësi (Banka) merr gjithashtu përgjegjësinë të furnizojë me cash ATM.
- 6.8 Qiramarrësi (Banka) nuk do të jetë përgjegjëse në rastet e mos funksionimit të ATM për shkaqe që nuk vijnë nga pakujdesia e rëndë e Bankës, përfshirë këtu keqfunksionimin e sistemit të Bankës, mosfunksionimin e rrjeteve të telekomunikimit të transferimit të të dhënave, ose rasteve të forcës madhore përkufizuar si raste ose ngjarje që janë tej kontrollit ose ndikimit të Bankës dhe nuk mund të parashikohen edhe nëse Banka tregon kujdes të veçantë, si dhe të gjitha ngjarjet për të cilat Banka nuk është përgjegjëse.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit (Bashkia Shkodër)

- 7.1 Qiradhënësi (Bashkia Shkodër) merr përsipër ti krijojë qiramarrësit mundësinë që të përdorë objektin qetësisht.
- 7.2 Qiradhënësi merr përsipër të sigurojë mundësinë për lidhjen me rrjetin elektrik të ATM dhe shenjës së ndriçuar.
- 7.3 Qiradhënësi është i detyruar t'i lehtësojë hyrjen punonjësve të Bankës dhe stafit teknik për të furnizuar, mirëmbajtur dhe riparuar ndonjë difekt.
- 7.4 Qiradhënësi siguron Bankën Tirana Bank se kjo kontratë për dhënie me qira nuk krijon asnjë konflikt me ndonjë interes të palëve të treta.
- 7.5 Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë me objektin dhe qëllimin e kontratës.
- 7.6 Struktura përgjegjëse për monitorimin e kontratës së qirasë është Sektori i Menaxhimit të Aseteve dhe Aksioneve të Ndërmarrjes, pranë Bashkisë Shkodër.

Neni 8


Ekskluziviteti – Penaliteti

- 8.1 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj kontrate, Pronari merr përsipër detyrimin të mos lejoje instalimin e ndonje ATM ose ofrimin e shërbimeve bankare nga ndonjë institucion tjetër krediti përveç "BANKA e TIRANES" Sh.a, në vendin e instalimit.
- 8.2 Shkelja e kushtit të ekskluzivitetit të BANKA e TIRANES për instalimin dhe përdorimin e ATM, do të shkaktojë penalizimin e Pronarit dhe detyrimin e tij për të paguar në favor të BANKA e TIRANES një penalitet në shumën Lek 0, që palët kontraktuese e pranojnë si ligjore dhe të arsyeshme.
- 8.3 Në rast aplikimi të penalitetit të sipërpërmendur, kjo kontratë do të përbejë një instrument të ekzekutueshëm, dhe përdoruesit tani e tutje deklarojnë se heqin dorë nga objeksionet e mundshme.

Neni 9

Kufizimi i përgjegjësisë së palëve

- 9.1 Secila prej paleve do të shpërblejë dëmet materiale që pala tjetër mund të pësojë pas vlerësimit të llojit të dëmit dhe masës së tij. Detyrimi i sipërpërmendur për shpërblimin e





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

dëmeve do të percaktohet në procesverbalet perkatese te mbajtura mes perfaqesuesve te paleve dhe vlera e tij do të jetë ajo e faturave përkatëse për riparimin e dëmit.

Neni 10 Dispozita të fundit

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do ti referohen dispozitave të Kodit Civil që rregullojnë kontratën e qirasë.

10.2 Kjo kontratë do të udhëhiqet dhe rregullohet nga legjislacioni shqiptar dhe çdo ndryshim i kushteve të kësaj kontrate midis palëve do të bëhet me shkrim.

10.3 Mosmarrëveshjet që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim mes palëve.

10.4 Në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës.

Palët kontraktuese ranë dakort sa më sipër dhe kjo kontratë u përgatit dhe u nënshkrua në tre (3) kopje origjinale.

Palët Kontraktuese

QIRADHËNËSI

BASHKIA SHKODER

**KRYETAR
Z. Benet Beci**

**Me Vendim delegimi
Z/Kryetar
Onid BEJLERI**



QIRAMARRËSI

TIRANA BANK

**Znj. Elona Sejko
Znj. Eralda Tafaj**

